AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Mars 2024

11.04.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin Mars 2024, viti bazë 2015=100.

Çmimet e konsumit shkuan në 2,3% vjetore dhe -0,3% mujore

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 2,3% në muajin mars 2024, krahasuar me muajin mars 2023. Inflacioni mujor ishte -0,3% në muajin mars 2024.

Mars 2024 / Mars 2023 2,3 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 2,3 % në muajin Mars 2024 krahasuar me muajin Mars 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pajisjet telefonike dhe të telefaksit (15,6%), pushime të organizuara (14,5%), energjia elektrike (13,2%), pijet alkoolike (10,7%), pemët (9,8%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (9,8%), peshqit (9,1%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (7,8%), sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat (6,7%), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (6,7%), shërbimet për transport (5,9%), gjërat dhe pajisjet tjera rekreative, kopshtet dhe manaret (5,1%), kafja, çaji dhe kakao (5,0%), gazetat, librat dhe materialet për zyra (4,8%), shërbimet rekreative dhe kulturore (4,3%), prodhimet ushqimore (3,8%), kujdesi personal (3,7%), shërbimet financiare (3,7%), mbrojtja sociale (2,8%), duhani (2,7%), shërbimet hoteliere (2,2%), shërbimet ambulantore (2,2%), perimet (1,5%), mishi (1,3%), pajisjet audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informatave (1,2%), dhe me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2,6 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: qumështi, djathi dhe vezët (-5,4%), vajrat dhe yndyrat (-5,0%) dhe karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-0,7%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,3 për qind në IHÇK-it.

Mars 2024 / Shkurt 2024 -0,3 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit pësoi rënie në një mesatare prej -0,3% në muajin mars 2024 krahasuar me muajin shkurt 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me rënien e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: energjia elektrike (-5,7%), shërbimet për transport (-1,8%), këpucë (-1,4%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-1,0%), qumështi, djathi dhe vezët (-0,9%), perimet (-0,8%), përdorimi i pajisjeve për transport personal (-

0.8%), pemët (-0,7%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (-0,5%), pijet alkoolike (-0,3%) dhe mishi (-0,2%), dhe me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,4 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa ngritje e çmimeve vërehet te nëngrupet e COICOP-it: veshje (2,3%) me një ndikim prej 0,1 për qind në IHÇK-it.

Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në % të matura nga IHÇK



Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2024 në ‰	III - 2024 2015=100	III- 2024 II- 2024	III - 2024 III - 2023
00	Gjithsej IHÇK	1000,0	130,0	-0,3	2,3
01	Ushqimi dhe pijet joalkoolike	351,1	144,7	-0,2	1,6
02	Pijet alkoolike, duhani	67,6	139,6	0,0	5,2
03	Veshje dhe këpucë	40,6	108,6	1,5	4,2
04	Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	89,8	125,6	-2,0	7,8
05	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	63,0	122,0	0,2	3,5
06	Shëndetësia	22,8	116,1	-0,1	2,0
07	Transporti	176,7	121,0	-0,7	-0,5
08	Mjetet e komunikimit	23,7	114,5	0,0	1,0
09	Rekracioni dhe kultura	44,5	106,5	0,1	4,5
10	Arsimi	6,9	104,0	0,0	-0,9
11	Restorantet dhe hotelet	40,8	129,5	0,0	2,1
12	Mallrat dhe shërbimet e ndryshme	72,2	119,1	0,2	2,1

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin mars 2024, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation